



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:004395

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05468090

P.nr.41/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE-DEGA KLINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, sipas Gjyqtares se vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në lëndën penale kundër të pandehurit H (B) G, nga fsh. Z K. K, i akuzuar për vepër penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje – Departamenti i Përgjithshëm, me PP/II Nr.377/2023 të datës 09.03.2023, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, dhe të pandehurit H.G, me dt. 05.03.2024, vendosi dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19 Mars 2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj:

Të pandehurit H.G, i lindur me dt..., në fsh. C, ndërsa tani me banim në fsh. Z. K. K, i biri i B. dhe nenës H, e vajzërisë M, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të dobët ekonomike, pensioner, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr..... i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt.... rreth orës ... minuta në fsh. Z. K. K, pikërisht në shtëpinë e tij, në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 5 par. 1 të Ligjit mbi armët (Ligji Nr. 05/L-

022) ka mbajtur në pronësi kontroll një pushkë gjuetie e modelit T. Ar, AV T. S., prodhim Turk, kalibri 12 mm, me nr. serik 850 C së bashku me 13 fishekë të kalibrit 12 Ga, e të cilën armë dhe municion e kanë sekuestruar nga i pandehuri, hetuesit policor me dt. 15.11.2022 gjatë një bastisje dhe kontrolli nga ana e hetuesve të DHTQNJ në Prishtinë.

-me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 42 par. 1 pika 1.2, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 69, 70, nenit 366 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 242, 364 si dhe 370 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

ME DËNIM ME KUSHT

Ashtu që:

I. Të akuzuarit H. G, e dënon më dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim, nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

II. Dënimi me kushte do ti revokohet konform nenit 50 të KPRK-së, nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese.

III. OBLIGOHET: I pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, si dhe tarifën për kompensim të viktimave të krimit shumën në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. dënim Plotësues: Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së, arma dhe fishekët me të dhënat si në dispozitiv të aktakuzës, të konfiskohet dhe më pas të njëjtat të shkatërrohen nga njësiti përkatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Peje – Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngrit aktakuzën PP/II nr.377/2023 të datës 09.03.2023 kundër të pandehurit H (B) G, nga fsh. Z.K. K, i akuzuar për veprë penal Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të të KPRK-së.

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrim të aktakuzës, ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore, vërtetoi se kompetente është kjo gjykatë.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me date 05.03.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit, dhe të pandehurin H. G, si mbrojtësit të tij Av. Miranda Avdyli.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri pas konsultimit paraprak të mbrojtësit të tij, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej ne barre, me vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi se shpreh pendesë për veprën penale të kryer. Po ashtu i pandehuri deklaroi se unë vet e kam dorëzuar pushkën e gjuetisë vullnetarisht.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që i pandehuri pranoi fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të lirë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden ne shkresa të lënda. I propozoj gjykatës që të pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale që i vihet ne barre, dhe me rastin e marrjes se vendimin, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

Po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit av. Miranda Avdyli e caktuar sipas detyrës zyrtare, ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me mbrojtësin tim. Mbrojtësja

deklaroi se i mbrojturi im ka lidhë marrëveshje për pranim fajësie në prokurori, ku është paraparë që ti shqiptohet dënim me gjobë, mirëpo nuk është caktuar gjoba, duke marrë parasysh faktin se ju keqësuar gjendja materiale e të mbrojturit tim, për shkak të sëmundjes së bashkëshortes së tij, që është dashur të operohet në Turqi nga mesi i vitit 2023. I propozojmë gjykatës që në vënd të dënimit me gjobë, të propozuar sipas marrëveshjes t'i shqiptohet një dënim me kusht, ngase edhe me shqiptimin e dënimit të tillë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit konform dispozitave ligjore.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprën penale, mbajtje në pronësi kontrollë ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, e po ashtu edhe në prokurori ka bërë marrëveshje për pranim fajësie, pendimin e tij, padënueshmerinë e tij më parë, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri ishte i singerte, nga ajo ditë e kryerjes së veprës penale, nuk ka kryer tjetër vepër penale, shihet se është rehabilituar, ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti asnjë rrethanë.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi me burgim iu shqiptua në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 2 (dy) vite nuk kryen vepër të re penale.

Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

Departamenti i Përgjithshëm Penal

P.nr.41/2023 me datë. 19.03.2024

Zyrtare Ligjore

Liridona Palushi

Gjyqtarja gjykuese

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.